



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:203655
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05874193

Ac.nr.7200/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtaret Hidajete Gashi Alaj, kryetare e kolegjit, Besnik Bislimaj dhe Burim Shala anëtarë, në çështjen juridike të paditësve 1.F.H.H ish nga fshati ... tani me vendbanim në Prishtinë ... rr.”V.F” pa nr., 2. M.B.H - gruaja e H.M.H i ndjerë, nga Prishtina rr.”...”, nr...., 3. M.H.H nga Prishtina rr.”...” nr.... dhe 4. J.M.H - vëllai i H.H, rr.”...”, nr...., të cilët i përfaqëson av.H.P nga Podujeva, me autorizim, kundër të paditurave 1. Komuna e Podujevës, e përfaqësuar nga Faik Rama me autorizim dhe 2. Autoriteti Pyjor i Kosovës me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga Lulzim Sopi, me autorizim, për vërtetim pronësie, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditësve, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, C.nr.144/08, të datës 16.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e paditësve 1.F.H.H ish nga fshati ... tani me vendbanim në Prishtinë ... rr.”V.F” pa nr., 2. M.B.H - gruaja e H.M.H i ndjerë, nga Prishtina rr.”...”, nr...., 3. M.H.H nga Prishtina rr.”...” nr.... dhe 4. J.M.H - vëllai i H.H, rr.”...”, nr...., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë –Dega në Podujevë, C.nr.144/08, i datës 16.07.2021, PRISHET dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të sërishëm.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.144/08, i datës 16.07.2021, ka vendosur si në vijim:

“I. REFUZOHET padia dhe kërkesëpafia e paditësve 1. F.H.H, 2. M.B.H - gruaja e H.M.Ht, 3. M.H.H dhe 4. J.M.H - vëllai i H.H që të gjithë nga Prishtina, kundër të paditurave 1. Komuna e Podujevës dhe 2. Autoriteti Pyjor i Kosovës (APK) me seli në Prishtinë, për vërtetim pronësie SI E PA BAZUAR, me të cilën kanë kërkuar që të: “Vërtetohet se të njëjtit janë bashkëpronar në bazë të trashëgimisë në ngastrën kadastrale nr.459/1 (ish ngastra kadastrale nr.2/3), me kulturë mal, kl.5-të, e cila gjendet në vendin e quajtur “Quka e ...s”, me sipërfaqe prej 06.25.00 ha, e cila evidentohet në Fletën Poseduese nr.160 ZK. ... dhe të detyrohen të paditurat që të bëjnë bartjen e pronësisë në emër të paditësve si dhe të paguajnë shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësinë që do të shkaktohen, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë”.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.”

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të paraparë ligjor ankesë kanë parashtruar paditësit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë dega në Podujevë të kthehet në rigjykim të shkallës së parë, apo kërkesëpafia e paditësve të aprovohet si e bazuar.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

-Ankesa e paditësve është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se paditësit përmes të autorizuarit të tyre me datë 23.05.2003 kanë paraqitur padi kundër të paditurave Komuna e Podujevës dhe Autoriteti Pyjor i Kosovës, për vërtetimin e pronësisë, mbi bazën e trashëgimisë.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë së paditësve, me aktgjykimin, C.nr.380/03 të datës 11.05.2005, e kishte aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e Qarkut në Prishtinë me aktvendimin Ac.nr.714/05 të datës 08.01.2007, e ka prish aktgjykimin C.nr.380/03 të datës 11.05.2005, dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje.

Pas kthimit në rigjykim dhe rivendosje Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë së paditësve, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe pas vlerësimit dhe administrimit të provave në shkresat e lëndës ka marrë aktgjykimin, C.nr.2677/10 të datës 13.12.2017 duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar ka theksuar se pas vlerësimit të provave materiale në shkresat e lëndës dëgjimit dhe deklarimit të palës paditëse në padi, deklarimit në seanca dhe përgjigjeve në padi të të paditurave dhe deklarimit të përfaqësuesve të tyre në seanca erdhi në përfundimin se padia dhe kërkesëpafia e paditësve është e pa bazuar dhe e njëjta është parashkruar siç kanë deklaruar të paditurat në kundërshtimet dhe pretendimet e tyre në këtë drejtim janë të bazuara dhe gjykata i mori si të tilla. Sipas Gjykatës së shkallës së parë nuk qëndron pretendimi i paditurës së parë Komuna e Podujevës se kjo paluajtshmëri e paditësve - ish ngastra kadastrale nr. 2/3 FP. nr.124 tani numër 469/1, FP nr.160 është eksproprijuar sipas aktvendimit të Sekretariatit për punë financiare nga Prishtina nr. vendimi 03.Nr.11514/59 të dt.08.09.1959. Ngase sipas vlerësimit dhe shikimit të këtij aktvendimi nga gjykata, askund nuk përmendet ngastra kadastrale kontestuese të jete eksproprijuar me këtë vendim. Andaj ky kundërshtim i paditurës është i pa bazuar. Po ashtu i pa bazuar dhe pa mbështetje në prova materiale është edhe pretendimi i paditurës së parë Komuna e Podujevës se i mungon asaj legjitimiteti real pasiv me qenë palë në procedurë sepse veprimet lidhur me këtë paluajtshmëri i ka kryer dhe vet DKGJP Komuna e Podujevës duke bërë ndryshimet në librat kadastral dhe ndërruar pronarin në vitin 1960 nga prona private me pronar H.L.H nga ... në emër të Ndërmarrjes pyjore "...” në Podujevë pra prej pronës private është regjistruar në librat kadastral të DKGJP në Podujevë, kjo ngastër si pronë shoqërore dhe tani e menaxhon APK me seli në Prishtinë. Prandaj e paditura ka legjitimitet real pasiv me qenë palë në procedurë në pajtim me dispozitat ligjore të LPK-së neni 73, 74, 75 dhe 76 të këtij ligji.

Tutje ka theksuar se, sipas dispozitës ligjore të LMTHPJ (Fletorja Zyrtare e RSFJ nr.6/1980) neni 29 përcakton se: "Mbi sendin në pronësinë shoqërore e drejta e pronësisë nuk mund të fitohet me parashkrim". Këtu të paditurat kanë të drejtë se paditësit edhe pse deklaruan se e kanë në posedim këtë ngastër një kohë të gjatë ato nuk kanë mundur ta fitojnë pronësinë mbi këtë ngastër sepse këtë nuk e lejon neni 29 i LMTHPJ. Sipas këtij ligji e drejta e pronësisë fitohet neni 20 par.1 sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgimi, ndërsa par. 2 përcakton se: "E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe mënyrën e caktuar me ligj". Siç bëhet fjalë në rastin konkret me të paditurën e dytë APK e ka fituar të drejtën e pronësisë me regjistrimin e saj në librat publik të tokës DKGJP në Podujevë në vitin 1960 dhe nga ky vit ajo është pronarë juridike e kësaj ngastre kadastrale që paditësit pretendojnë se e kanë fituar pronësinë si bashkëpronar në emër të trashëgimisë së paraardhësve të tyre dhe me parashkrim që nuk qëndron kjo dhe nuk mbështetet në prova materiale. Kjo ka qenë deri në vitin 1952 por prej vitit 1960 e tutje kjo paluajtshmëri është e regjistruar si pronë shoqërore e Ndërmarrjes Pyjore "...” në Podujevë dhe tani menaxhohet nga APK me seli në Prishtinë.

Por gjykata e shkallës së parë ka theksuar se e mori në tërësi si të bazuar dhe ia dha besimin e plotë ekspertizës së lartpërmendur, ngase ekspertiza i përmban elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore. Ekspertet në ekspertizë kanë deklaruar se sipas elaboratit kadastral qysh nga viti 1960 evidentohet si pronë shoqërore e ndërmarrjes pyjore "...” në Podujevë, FP. Nr.160 ZK. ... me numër ngastre 469/1, me kulturë mal, klasi 5 me sipërfaqe prej 15.48.21 ha dhe në të njëjtën ngastër mal, kl.6, me sipërfaqe prej

23.82.72 ha dhe sipërfaqja e përgjithshme është 39.30.93 ha. Sipërfaqja kontestuese nga kjo ngastër është 06.25.00 ha kufizohet në jug me ngastrën kadastrale nr. 470 dhe 475 me pronar A.H.H nga ..., në lindje me rrugë publike, ndërsa në veri dhe perëndim gjithashtu me rrugë publike. Sipas kadastrit përshkrues të vitit 1952 kjo ngastër evidentohet si pronë private me nr. ngastre 2/3, vendi i quajtur “Quka e ...s”, me kulturë mal, kl.5, me sipërfaqe prej 06.25.00 ha, FP.124 ZK. ... në emër të H.L.H.

Tutje ka theksuar se nuk qëndron deklarimi i palës paditëse se janë pronar të kësaj ngastre kadastrale sepse e njëjta tani evidentohet si pronë shoqërore dhe e menaxhon APK me seli në Prishtinë. Kjo ngastër – paluajtshmëri ka kaluar dhe regjistruar në emër të Ndërmarrjes “...” në Podujevë e tani menaxhohet nga APK në Prishtinë. Kjo paluajtshmëri është e regjistruar në emër të paditurës së dytë APK pas Aerofotografimit Ajror të kryer në vitin 1960 dhe nga kjo periudhë është e regjistruar pranë DKGJP dhe nuk qëndron fakti se kjo paluajtshmëri është eksproprijuar siç pretendon e paditura e parë Komuna Podujevës sepse ky pretendim nuk gjen mbështetje në asnjë provë materiale. Por fakti se kjo paluajtshmëri - ngastër kadastrale ka kaluar në emër të paditurës së dytë APK këtë e vërteton dhe ekspertiza e eksperteve të gjeodezisë Shefqet Maloku dhe Fahri Ademi të hartuar me shkrim me dt.14.06.2004. Në ekspertizë është konstatuar se sipas elaboratit kadastral sipas gjendjes që disponon kjo drejtori që nga viti 1960 sipas Aerofotografimit Ajror kjo ngastër evidentohet si pronë shoqërore e Ndërmarrjes “...” në Podujevë FP. Nr.160 ZK. Andaj meqenëse u vërtetua se kjo ngastër ka kaluar në emër të ndërmarrjes “...” në Podujevë sipas Aerofotografimit Ajror të realizuar në vitin 1960. Atëherë qëndron konstatimi dhe kundërshtimi i dy të paditurave se paditësit i kanë humbur dhe lëshuar afatet ligjore me kërkuar të drejtat e tyre dhe kthimin e paluajtshmërisë në pronësi të tyre.

Sipas Ligjit të Punës së bashkuar neni 268 par.1 (G.Z. RSFJ) i cili ka qenë në fuqi kur kjo paluajtshmëri ka kaluar në emër të paditurës APK si pronë shoqërore me këtë nen përcaktohet se: ”Nëse paluajtshmëria ka kaluar në pronësi shoqërore pa bazë juridike, kthimi i saj mund të kërkohej në afat prej 5 viteve duke filluar nga data e marrjes në dijeni, e më së voni në afat prej 10 vitesh”. Po ashtu gjykata kishte kërkuar nga pala paditëse me aktvendimin e saj C.nr.144/08 të datës 30.03.2021, që të bëjë rregullimin e padisë me sigurimin e provës - historiatin e ngastrës kadastrale kontestuese të cekur edhe në procesverbalin e datës 19.10.2020 në aktvendimin e procesverbalit, mirëpo pala paditëse nuk ka vepruar konform këtij vendimi dhe gjykata konstaton se e njëjta ka hequr dorë nga administrimi i kësaj prove. Andaj meqenëse ka kaluar ky afat ligjor dhe paditësit nuk i kanë shfrytëzuar mjetet juridike me ankesë për ti realizuar të drejtat e tyre dhe kanë kaluar më tepër se 40 vite nga koha kur paluajtshmëria e tyre ka kaluar në pronësi shoqërore atëherë nuk kanë të drejtë më tej të kërkojnë kthimin e tyre dhe kemi parashkrim të padisë dhe të kërkesëpadisë së paditësve. Çështja e parashkrimit është e rregulluar dhe me dispozitat ligjore të LMD-së neni 360, neni 371 dhe neni 379 të LMD-së 1978.

Prandaj pa dyshim u vërtetua me prova materiale që gjinden në shkresat e lëndës se kjo paluajtshmëri e paditësve ka kaluar në emër të APK me seli në Prishtinë dhe evidentohet si pronë shoqërore sipas Aerofotografimit Ajror në vitin 1960 dhe nga kjo periudhë kanë kaluar më tepër se 40 vite atëherë gjykata e refuzoj si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve sepse ka arritur parashkrimin kërkesa e tyre dhe kanë humbur çdo të drejtë me kërkuar kthimin e saj sipas dispozitës ligjore të nenit 268.1 të Ligjit të Punës Bashkuar. Gjithashtu nuk janë të bazuara

pretendimet e palës paditëse se ajo e shfrytëzon paluajtshmërinë një kohë të gjatë dhe se e ka fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues sepse kjo ngastër kadastrale nr.229-0 është e evidentuar si pronë shoqërore dhe këtë e ndalon që të kalojë në pronë private neni 29 i LTHMPJ 1980. Për t'u bërë pronarë i një paluajtshmërie (sendi) sipas LMTHPJ-së duhet që të plotësohen disa kushte dhe duke u bazuar në nenin 20 të ligjit thuhet se e drejta e pasurisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe trashëgimin por dhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj. Një nga mënyrat e fitimit të pasurisë parashihet me nenin 20 sipas ligjit është edhe parashkrimi fitues.

Po t'i referohemi nenit 28 LTHMPJ kur ceket se mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të paluajtshëm mbi të cilin tjetri ka të drejtë posedimit e fiton të drejtën mbi këtë send me parashkrim fitues me kalimin e kohës prej 10 viteve neni 28 par.2 kurse par.4 neni 28 cek se mbajtësi në mirëbesim i sendit të paluajtshëm për 20 vite. Mirëpo edhe me këtë nen nuk ka të drejtë pala paditëse sepse nuk mund të thuhet se paditësit e kanë mirëbesimin kur deklarojnë se e kanë posedua dhe e shfrytëzojnë edhe tani. E shfrytëzojnë këtë ngastër gjatë tërë këtyre viteve paluajtshmërinë kontestuese sepse që në fillim ajo e ka ditur se sendi (paluajtshmëria) është e huaja ajo dhe është e evidentuar në emër të paditurës dytë APK ose është dashur ta dinë këtë rrethanë por kanë menduar se po e mbajnë dhe nuk po i pengon askush dhe një ditë do bëhej prona e tyre. Por meqenëse në rastin konkret kemi keqbesim të tyre dhe nuk është i ligjshëm sepse nuk e mbajnë atë me asnjë bazë juridike të paraparë me këtë ligj. Andaj duke ju referuar nenit 72 par.1 dhe 2 të LTHMPJ në këtë rast kemi të bëjmë me mbajtje në posedim të paluajtshmërisë me keqbesim nga paditësit dhe pa asnjë bazë juridike. Shtrohet pyetja ku ishte pala paditëse gjithë këto vite prej vitit 1960 deri në vitin 2003 që nuk ka ndërmarr veprime dhe nuk ka kërkuar njohjen dhe kthimin e drejtës së pronësisë nëse ata kanë menduar se kanë këtë të drejtë por këtë nuk e kanë bërë.

Gjithashtu edhe me ligjin mbi token bujqësore GZ. KSAK nr.21 në dispozitën e saj të nenit 6 par.2 thuhet se në token bujqësore të pronësisë shoqërore nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë përmes mbajtjes. Andaj pala paditëse i ka lëshuar të gjitha afatet dhe nuk ka kërkuar brenda afatit me i realizua të drejtat e tyre nëse kanë menduar se ato u janë shkelur dhe ju ka marrë paluajtshmëria e cila është regjistruar gabimisht siç thotë ajo në pronësi shoqërore. Andaj gjykata i aprovoj kundërshtimet e palës se paditur si të drejta dhe kjo u vërtetua dhe me prova në procedurë se të njëjtat kanë pasur të drejtë me kundërshtimet e saja kurse pala paditëse nuk arriti ta bind gjykatën se kërkesëpadia e saj është e bazuar në prova sepse kjo nuk u vërtetua me asnjë provë të vetme materiale edhe pse kjo kërkohet nga palët sipas nenit 7.1 lidhur me nenin 319.1 të LPK-së.

Gjykata lidhur me vendimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore e bazojë në nenin 450 të LPK-së, udhëzimi administrativ 01/2017 për unifikim të taksave gjyqësore KGJK, ku secila palë i bartë shpenzimet e veta, pasi që më parë kishte paguar shumën prej 20 € për taksë gjyqësore.

Gjykata e Apelit e Kosovës nuk e pranon vlerësimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i atakuar me ankesë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi

1 lidhur me nenin 160 paragrafi 4 të LPK-së, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ndërsa po ashtu e drejta materiale është zbatuar gabimisht.

Qëndron pretendimi ankimor se, aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, ngase sipas paditësve dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptimtë dhe në kundërshtim me arsyet e dhëna, përkatësisht nuk përmban arsyeje të mjaftueshme për faktet relevante, e gjithashtu për faktet relevante ekzistojnë kundërtënie në mes të asaj se çka thuhet në arsyet e aktgjykimit mbi përmbajtjen e shkresave të lëndës, për Gjykatën e Apelit është pretendim i themeltë.

Aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, për faktin se, Gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë për bazë vërejtjet e dhëna nga Gjykata e shkallës së dytë me aktvendimin Ac.nr.714/05 të datës 11.05.2005 dhe kjo përben shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore.

Aktgjykimi i atakuar në pjesën arsyetuese nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, ato arsye që janë dhënë nuk janë në përputhje njëra me tjetrën, nuk përmban arsye të mjaftueshme të provave të administruara mbi bazën e të cilave ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Gjykata në dispozitiv e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve për ngastrën kadastrale nr.459/1 (ish ngastra kadastrale nr.2/3), me kulturë mal, kl.5-të, e cila gjendet në vendin e quajtur “Quka e ...s”, me sipërfaqe prej 06.25.00 ha, e cila evidentohet në Fletën Poseduese nr.160 ZK. ..., ndërsa në arsyetim të aktgjykimit flet për ngastrën kadastrale 469/1.

Qëndrojnë pretendimet ankimore se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, për shkak se, edhe pse ka dalë në vendshikim nuk e ka bërë identifikimin e pjesës së ngastrës lëndore me të gjitha përkufizimet dhe matjet gjeodezike që ka qenë e domosdoshme, njëkohësisht ka qenë vërejtje edhe në aktvendimin Ac.nr.714/05 të datës 11.05.2005 të Gjykatës së Qarkut. Çështja tjetër e pasqaruar nga Gjykata e shkallës së parë ka të bëjë me atë se, a është eksproprijuar pjesa e ngastrës lëndore sipas aktvendimit të Sekretariatit për Ekonomi të Komunës 03 nr.11514/59 të datës 08.02.1959 dhe si ka ardhur deri të ndryshimi kadastral. Paditësi në paditësit në padi kanë pretenduar se, prona lëndore është uzurpuar nga e paditura e parë dhe nuk bëhet fjalë për eksproprijim, atëherë gjykata e shkallës së parë është dashur të sqaroj këtë rrethanë nëse për ngastrën lëndore është zhvilluar procedurë e eksproprijimit apo si ka kaluar në emër të të paditurës nga viti 1960. Nëse paditësit sipas kërkesës së gjykatë nuk kanë mundur të sigurojnë dokumentacionin e kërkuar nga gjykata e shkallës së parë sipas aktvendimit procedural C.nr.144/2018 të datës 30.03.2021, atëherë e njëjta me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, është dashur që zyrtarisht të kërkoj nga e paditura Historiatin e ngastrës lëndore, dosjen sipas vendimit 03 nr.11514/59 të datës 08.02.1959. Pastaj të kërkoj plotësimin e ekspertizës së gjeodezisë në mënyrë që të merret historiati i ngastrës lëndore, përkufizimet e pjesës së ngastrës lëndore, të qartësohet se a kemi të bëjmë me ngastrën lëndore sipas padisë së paditësve 459/1 (ish ngastra kadastrale nr.2/3) apo ngastra kadastrale 469/1 siç është përshkruar në arsyetim të aktgjykimit të atakuar dhe në ekspertizën e datës 14.06.2004. Paditësit me padi kanë kërkuar vërtetimin e pronësisë mbi bazën e trashëgimisë, atëherë gjykata e shkallës së parë është dashur të vlerësoj nëse janë plotësuar

kushtet për fitimin e të drejtës së pronësisë mbi bazën e trashëgimisë, apo nëse ngastra lëndore është pronë shoqërore a mundën paditësit të kërkojnë vërtetimin e pronësisë mbi bazën e trashëgimisë në pronë shoqërore apo me parashkrim fitues ashtu siç janë dhënë arsye në aktgjykimin e atakuar, pra në çfarë baze është kërkuar e drejta e pronësisë në ngastrën lëndore, sepse nga arsyetimi i aktgjykimit të atakuar nuk janë dhënë arsye të plota se në çfarë baze është kërkuar vërtetimi i pronësisë.

Meqenëse gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë atëherë kemi edhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për këtë arsye aktgjykimi i atakuar është dashur të prishët dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Në rigjykim gjykata duhet të eliminojë të metat që e kanë përcjell aktgjykimin e atakuar në atë mënyrë që fillimisht të vërtetojë drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, duke dalë prapë në vendshikim me ekspert të gjeodezisë, duke siguruar historiatin e pronës lëndore, dosjen sipas vendimit 03 nr.11514/59 të datës 08.02.1959, të qartësohet se a kemi të bëjmë me ngastrën lëndore sipas padisë së paditësve 459/1 (ish ngastra kadastrale nr.2/3) apo ngastra kadastrale 469/1 siç është përshkruar në arsyetim të aktgjykimit të atakuar dhe në ekspertizën e datës 14.06.2004, pastaj të kërkojë nga ekspertet e gjeodezisë plotësimin e ekspertizës ashtu që të përcaktojnë pjesën e sipërfaqes, përkufizimet e ngastrës lëndore, ndërsa pas vërtetimit të plotë të gjendjes faktike të zbatojë drejtë dispozitat e të drejtës materiale duke pasur parasysh bazën ligjore për vërtetimin e pronësisë, nëse kërkohet mbi bazën e trashëgimisë atëherë a mund të fitohet e drejta e pronësisë në pronë shoqërore mbi bazën e trashëgimisë dhe krejt në fund vendimi me qenë në harmoni me kërkesat që dalin nga neni 160 paragrafi 4 dhe 5 i LPK-së.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 pika (c) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7200/2021, me datë 28.06.2024

Kryetare e kolegjit
Hidajete Gashi Alaj, d.v.